



Bazuar në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77/16 gusht 2010) dhe nenin 16, paragrafi 2, dhe nenin 85, paragrafi 1, të Ligjit nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/11 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore, në mbledhjen e mbajtur më datë 29 nëntor 2018 miratoi këtë:

RREGULLORE PËR TREGUESIN E LEVERAZHIT

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj rregullore është të përcaktoj një tregues të leverazhit që është i thjeshtë, transparent, jo i bazuar në rrezik për të vepruar si masë kredibile shtesë ndaj kërkesave të kapitalit të bazuara në rrezik.
2. Treguesi i leverazhit ka për qëllim të kufizoj rritjen e leverazhit në sektorin bankar për të evituar proceset destabilizuese të deleverazhit të cilat mund të dëmtojnë sistemin më të gjerë financiar dhe ekonominë dhe për të fuqizuar kërkesat e bazuara në rrezik me një masë të thjeshtë dhe jo të bazuar në rrezik.
3. Kjo rregullore aplikohet për të gjitha bankat e licencuara nga BQK-ja për të operuar në Republikën e Kosovës, me përjashtim të degëve të bankave të huaja.

Neni 2

Përkufizimet

1. Termat e përdorura në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuara sipas Ligjit Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare jobankare (në vijim: Ligji për bankat), apo siç janë përkufizuar më poshtë për qëllimin e kësaj rregullore:
 - 1.1. **Kundërpala qendrore** – nëkupton shtëpi kliringu e cila qëndron ndërmjet kundërpalëve të kontratave të tregtuara në një apo më shumë tregje financiare, duke vepruar si blerës për çdo shitës dhe si shitës për çdo blerës, dhe në këtë mënyrë të sigurojë performancën e ardhshme të kontratave të hapura. Kundërpala qendrore bëhet kundërpalë për tregtimet

me pjesëmarrës të tregut përmes novacionit (d.m.th, shlyerjes së një borxhi apo të një detyrimi/obligacioni të vjetër nëpërmjet një borxhi apo të një detyrimi të ri), një sistemi të ofertimit të hapur, apo ndonjë marrëveshje tjetër që është ligjërish e zbatueshme. Për qëllim të kësaj rregulloreje, kundërpala qëndrore është një institucion financiar.

- 1.2. **Kundërpala qëndrore e kualifikuar** – nënkupton një entitet që është licencuar për të operuar si një kundërpalë qëndrore, dhe lejohet nga rregullatori/mbikëqyrësi i duhur për të operuar si i tillë për produktet që i ofron. Kjo është subjekt i dispozitës që kundërpala qëndrore është e vendosur dhe mbikëqyrur me kujdes në juridiksionin ku rregullatori/mbikëqyrësi relevant ka vendosur rregullat dhe rregulloret e brendshme që janë në pajtueshmëri me principet për infrastrukturën e tregjeve financiare (CPSS-IOSCO) dhe ka treguar publikisht që kjo aplikohet ndaj kundërpalës qëndrore në bazë të vazhdueshme.
- 1.3. **Anëtar i kliringut** –nënkupton një anëtar apo pjesëmarrës direkt në një kundërpalë qëndrore që ka të drejtë të hyjë në një transaksion me kundërpalën qëndrore, pavarësisht nëse hyn në tregtim me kundërpalën qëndrore për qëllime të mbrojtjes (ang. hedging), investimit apo spekulimit apo nëse gjithashtu hyn në tregtime si ndërmjetësues financiar ndërmjet kundërpalës qëndrore dhe pjesëmarrësve të tjerë në treg.
- 1.4. **Klienti** - nënkupton një palë në transaksion me kundërpalën qëndrore ose përmes një anëtari të kliringut që vepron si ndërmjetësues financiar ose përmes një anëtari të kliringut që garanton performancën e klientit ndaj kundërpalës qëndrore.
- 1.5. **Margjina fillestare** - nënkupton kolateralin e financuar të një anëtari të kliringut apo të një klienti të dërguar te kundërpala qëndrore për të zvogëluar ekspozimin e mundshëm të së ardhmes të kundërpalës qëndrore ndaj anëtarit të kliringut që rrjedh nga ndryshimi i mundshëm në të ardhmen në vlerën e transaksioneve të tyre.
- 1.6. **Margjina ndryshuese** - nënkupton kolateralin e financuar të një anëtari të kliringut apo të një klienti të dërguar në baza ditore apo brendaditore te kundërpala qëndrore bazuar në lëvizjen e çmimeve të transaksioneve të tyre.
- 1.7. **Ekspozimet tregtare** –nënkupton ekspozimet aktuale dhe ekspozimet e mundshme të së ardhmes të një anëtari të kliringut apo të një klienti ndaj një kundërpale qëndrore që rrjedhin nga derivativët në tregjet jashtë bursave, transaksionet e derivativëve të tregtuara në bursë apo transaksionet e financimit të letrave me vlerë, si dhe margjina fillestare. Ekspozimi aktual i anëtarit të kliringut përfshinë margjinën ndryshuese për tu paguar ndaj anëtarit të kliringut mirëpo që nuk është pranuar ende.
- 1.8. **Fondet dështuese** gjithashtu të njohura si depozitat për shlyerje apo kontributet e fondeve garantuese (apo ndonjë emërtim tjetër), - nënkupton kontributet e financuara apo të pafinacuara të anëtarëve të kliringut apo nënshkrimi i marrëveshjeve të përbashkëta të kundërpalës qëndrore për ndarjen e humbjeve. Përshkrimi i dhënë nga kundërpala qëndrore për marrëveshjet e saj të përbashkëta për ndarjen e humbjeve nuk

është përcaktues i statusit të tyre si fond dështues; përkundrazi, përmbajtja e marrëveshjeve të këtij lloji do të qeverisë statusin e tyre.

- 1.9. **Transaksion shlyerje** - nënkupton anën e transaksionit midis anëtarit të kliringut dhe kundërpalës qëndrore atëherë kur anëtari i kliringut vepron në emër të klientit (p.sh., kur anëtari i kliringut shlyen apo ripërtërinë transaksionin e klientit).
- 1.10. **Transaksionet për shlyerje të gjata** – nënkupton transaksionet që një kundërpalë merr përsipër të dorëzojë një letër me vlerë, një mall (ang. a commodity) ose një shumë të këmbimit valutor kundrejt parasë së gatshme, instrumenteve të tjera financiare, ose malli (ang. commodity), apo anasjelltas, në një datë shlyerje ose dorëzimi, që është i specifikuar në kontratë si më i shkurti ndërmjet standardeve të tregut për këtë instrument të veçantë dhe pesë ditë pune pas datës që banka hynë në transaksion;
- 1.11. **Transaksionet e financimit të letrave me vlerë** –nënkupton transaksionet si marrëveshjet e riblerjes, marrëveshjet e anasjellta të riblerjes, huadhënia dhe huammarja e letrave me vlerë, transaksionet e kreditimit marginal, kur vlera e transaksioneve varet nga vlerësimet e tregut dhe transaksionet janë shpesh subjekt i marrëveshjeve marginale.
- 1.12. **Transaksionet e kreditimit marginal** - nënkupton transaksionet që një bankë lejon kredi në lidhje me blerjen, shitjen, mbajtjen apo tregtimin e letrave me vlerë. Transaksionet e kreditimit marginal nuk përfshijnë kreditë tjera që janë të siguruara me kolateral në formë të letrave me vlerë. Në përgjithësi, në këto transaksione, vlera e kredisë mbulohet me anë të letrave me vlerë që kanë vlerë më të madhe se shuma e kredisë.
- 1.13. **Grup Netimi** -nënkupton një grup i transaksioneve me një kundërpalë të vetme që janë subjekt i një marrëveshje bilaterale netimi ligjërisht të zbatueshme dhe për të cilën netimi është i njohur për qëllime të kapitalit rregullator.
- 1.14. **Pozicioni i rrezikut** -nënkupton një numër i cili i caktohet një transaksioni sipas metodës standarde për rrezikun kreditor nga kundërpalë duke përdorur një algoritm rregullator.
- 1.15. **Grup mbrojtës** -nënkupton një grup i pozicioneve të rrezikut që rrjedhin nga transaksionet me një grup netimi të vetëm për të cilat vetëm bilanci i tyre është relevant për të përcaktuar shumën e ekspozimit apo ekspozimin në dështim sipas metodës standarde të rrezikut kreditor të kundërpalës.
- 1.16. **Marrëveshje marginale** është një marrëveshje kontraktuale sipas të cilës një kundërpalë duhet të ofrojë kolateral për një palë të dytë kur ekspozimi i kundërpalës së dytë ndaj kundërpalës së parë tejkalon nivelin e përcaktuar.
- 1.17. **Vlera aktuale e tregut** është vlera neto e tregut e portfolios së transaksioneve brenda marrëveshjes së netimit me kundërpalën. Në llogaritjen e kësaj vlere përfshihen vlerat pozitive dhe negative të tregut.
- 1.18. **Ekspozimi aktual** është më i madh se zero, apo vlera e tregut të një transaksioni apo e portfolios së transaksioneve brenda marrëveshjes së netimit me kundërpalën që do të

ishte humbur në rast të dështimit të kundërpalës, duke supozuar asnjë kthim të vlerës nga këto transaksione në rast të falimentimit. Ekspozimi aktual shpesh quhet edhe Kosto zëvendësuese.

- 1.19. **Netimi kryq i produkteve** - nënkupton përfshirjen e transaksioneve të kategorive të ndryshme të produkteve brenda një grupi të njëjtë të netimit sipas rregullave të netimit kryq të produkteve.
- 1.20. **Derivatvët kreditorë** - kanë të njëjtin kuptim siç përcaktohet me Rregulloren për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave.

Neni 3

Definicioni dhe kërkesa minimale

1. Treguesi i leverazhit definohet si masa e kapitalit (numëruesi) pjesëtuar me masën e ekspozimit (emëruesi), me këtë tregues e shprehur si përqindje:
 - 1.1. Treguesi i leverazhit = Masa e kapitalit / Masa e ekspozimit
2. Kërkesa minimale për treguesin e leverazhit është 3%.

Neni 4

Masa e kapitalit

Masa e kapitalit për treguesin e leverazhit është Kapitali i klasës së parë sipas kapitalit të bazuar në rrezik të definuar në Nenin 6 të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave.

Neni 5

Masa e ekspozimit

1. Masa e ekspozimit për treguesin e leverazhit në përgjithësi duhet të bazohet në vlerën kontabël, subjekt i pikave të mëposhtme:
 - 1.1. Ekspozimet jo-derivative si zëra bilancor përfshihen në masën e ekspozimit neto nga provizionet specifike apo rregullimet e vlerësimit kontabël (p.sh., përshtatjet e vlerësimit kreditor kontabël).
 - 1.2. Netimi i kredive dhe depozitave nuk lejohet.
2. Bankat nuk duhet të përfshijnë kolateralin fizik apo financiar, garancitë apo teknikat tjera të zbutjes të rrezikut kreditor për të zvogëluar masën e ekspozimit.
3. Gjithsej masa e ekspozimit të një banke llogaritet si shuma e ekspozimeve të mëposhtme:
 - 3.1. ekspozimet bilancore;
 - 3.2. ekspozimet derivative;

- 3.3. ekspozimet e transaksionit të financimit të letrave me vlerë (ang. Securities financing transaction-SFT); dhe
- 3.4. zërat jashtëbilancor.

Neni 6

Ekspozimet bilancore

1. Bankat duhet të përfshijnë të gjitha asetet e bilancit në masën e ekspozimit, duke përfshirë kolateralin e derivativëve dhe kolateralin e transaksioneve të financimit të letrave me vlerë të paraqitura si zëra bilancor, me përjashtim të derivativëve dhe transaksioneve të financimit të letrave me vlerë si asete që janë të mbuluara me nenet 7 dhe 8 të kësaj rregullore.
2. Bankat mund të zbresin nga masa e ekspozimit asetet bilancore që janë të zbritura nga Kapitali i klasës së parë.
3. Zërat e detyrimeve nuk duhet të zbriten nga masa e ekspozimit.

Neni 7

Ekspozimet derivative

1. Bankat duhet të llogarisin ekspozimet e tyre derivative, përfshirë rastet kur banka shet mbrojtje duke përdorur një derivativ kreditor, si kosto zëvendësuese “RC” (ang. replacement cost) për ekspozimin ekzistues duke shtuar edhe një vlerë shtesë (ang. add-on) për ekspozimet e mundshme të së ardhmes (ang. potential future exposure - PFE), siç definohet në paragrafin 4 të këtij neni.
2. Për ekspozimet derivative të mbuluara me një kontratë bilaterale netimi të pranueshme (ang. eligible bilateral netting contract) të specifikuar në Aneksin 1 të kësaj rregullore netimi kryq i produkteve (ang. cross-product netting) nuk lejohet për të përcaktuar masën e ekspozimit të treguesit të leverazhit.
3. Derivatvët kreditorë të shkruar (ang. written credit derivatives) janë subjekt i trajtimit shtesë, të përcaktuar në paragrafët 14 deri 16 të këtij neni.
4. Për një ekspozim të vetëm derivativ që nuk është i mbuluar me kontratë bilaterale netimi të pranueshme (ang. eligible bilateral netting contract) siç është specifikuar në paragrafët 8 dhe 9 të Aneksit 1 të kësaj rregullore, shuma që duhet të përfshihet në masën e ekspozimit llogaritet si më poshtë:
 - 4.1. *Masa e ekspozimit = kosto zëvendësuese (RC) + vlera shtesë (add-on)*, ku *RC* – nënkupton kosto zëvendësuese e kontratës (sipas vlerës së tregut), atëherë kur kontrata ka vlerë pozitive, ndërsa *add-on* – nënkupton një shumë për ekspozimet e mundshme të së ardhmes (ang. potential future exposures), përgjatë kohëzgjatjes së mbetur të kontratës, e llogaritur duke aplikuar faktorin e vlerës shtesë në shumën nacionale të

principalit të derivativit. Faktorët e vlerës shtesë janë të përshkruar në paragrafët 2 dhe 4 të Aneksit 1 të kësaj rregullore.

5. Kur një kontratë bilaterale netimi e pranueshme është duke u aplikuar ashtu siç specifikohet në paragrafët 8 dhe 9 të Aneksit 1 të kësaj rregullore, kosto zëvendësuese (RC) për një grup të ekspozimeve derivative të mbuluara me kontratë do të jetë kosto zëvendësuese neto dhe vlera shtesë (add-on) do të jetë “ANet” e llogaritur sipas paragrafit 11 të Aneksit 1 të kësaj rregullore.
6. Gjatë llogaritjes së shumës së ekspozimit sipas paragrafëve 1 deri 5 të këtij neni, bankat nuk duhet të zvogëlojnë shumën e ekspozimit me kolateralin e pranuar nga kundërpala.
7. Bankat duhet të përfshijnë në masën e ekspozimit shumën e çdo kolateralit të dhënë për derivativin në rastet kur provizioni për atë kolateral ka zvogëluar vlerën e aseteve të bilancit të gjendjes.
8. Pjesa në para të gatshme e margjinës ndryshuese (ang. Variation margin) e shkëmbyer ndërmjet kundërpalëve mund të kuptohet si një formë e pagesës së para-shlyerjes (ang. pre-settlement payment), nëse kushtet e mëposhtme janë plotësuar:
 - 8.1. Paraja e gatshme e pranuar nga kundërpala pranuese nuk ndahet për ato tregtime të cilat nuk shlyhen përmes kundërpalës qendrore të kualifikuar (ang. Qualifying Central Counterparty - QCCP).
 - 8.2. Margjina ndryshuese llogaritet dhe shkëmbehet në baza ditore bazuar në vlerësimin sipas vlerës së tregut (ang. mark-to-market) të pozicioneve derivative.
 - 8.3. Margjina ndryshuese në para të gatshme pranohet në valutën e njëjtë sikurse valuta e shlyerjes së kontratës derivative.
 - 8.4. Margjina ndryshuese që shkëmbehet është shuma e plotë e nevojshme për të shlyer plotësisht vlerën e tregut të ekspozimit të derivativit, subjekt i limiteve dhe shumave minimale të transferuara të aplikueshme për kundërpalën.
 - 8.5. Transaksionet e derivativëve dhe margjinat ndryshuese janë të mbuluara me një kontratë netimi master të vetme (ang. single master netting agreement- MNA) ndërmjet entiteteve ligjore që janë kundërpalë në transaksionin e derivativëve. Kontrata netimi master e vetme duhet të përcaktojë në mënyrë eksplicite që kundërpalët pajtohen të shlyejnë çdo pagesë të detyrimeve të mbuluara me këtë lloj kontrate, duke marrë parasysh çdo margjinë ndryshuese të pranuar apo të dhënë në rast të ndodhjes së ngjarjes kreditore që përfshinë cilëndo kundërpalë. Kontrata netimi master e vetme duhet të jetë ligjërisht e zbatueshme dhe efektive në të gjitha jurisdikSIONET relevante, duke përfshirë ngjarjet e dështimit, falimentimit apo insolvencës.
9. Nëse kushtet e përcaktuara në paragrafin 8 të këtij neni janë plotësuar, pjesa në para të gatshme e margjinës ndryshuese e pranuar mund të përdoret për të zvogëluar pjesën e koston zëvendësuese (ang. replacement cost) të masës së ekspozimit të treguesit të leverazhit, dhe

asetet e arkëtueshme nga margjina ndryshuese në para të gatshme e dhënë mund të zbriten nga masa e ekspozimit të treguesit të leverazhit si në vijim:

- 9.1. Në rastet kur margjina ndryshuese në para të gatshme pranohet, banka pranuese mund të zvogëlojë koston zëvendësuese (por jo edhe pjesën e vlerës shtesë) të shumës së ekspozimit të derivativit si aset me shumën e pranuar në para të gatshme nëse vlera pozitive e tregut e kontratës apo kontratave derivative nuk është zvogëluar deri më tani me shumën e njëjtë të margjinës ndryshuese në para të gatshme të pranuar sipas standardit kontabël të përdorur nga banka.
 - 9.2. Në rastet kur margjina ndryshuese në para të gatshme e ofruar të ndonjë kundërpalë, banka dërguese mund të zvogëlojë të arkëtueshmet që rrjedhin nga masa e ekspozimit të treguesit të leverazhit, ku margjina ndryshuese në para të gatshme ka qenë e njohur si aset sipas standardit kontabël të përdorur nga banka.
10. Margjina ndryshuese në para të gatshme mund të mos përdoret për të zvogëluar shumën e ekspozimeve të mundshme të së ardhmes (PFE), përfshirë edhe llogaritjen e raportit neto/bruto (NGR) siç përcaktohet në paragrafin 11 të Aneksit 1.
 11. Për bankat të cilat ushtrojnë funksionin si anëtarë të kliringut (Cleraring member-CM) dhe ofrojnë shërbimet e kliringut për klientët, ekspozimet tregtare të anëtarëve të kliringut ndaj kundërpalës qendrore që rrjedhin atëherë kur anëtari i kliringut obligohet të rimburojë klientin për çdo humbje që rrjedh nga ndryshimet në vlerë të transaksioneve në rastin e dështimit të kundërpalës qendrore (CCP), duhet të trajtohen në mënyrë të njëjtë sikurse aplikohet për çdo lloj tjetër të transaksioneve të derivativëve.
 12. Në rastet kur anëtari i kliringut, bazuar në marrëveshjen e kontraktuar me klientin, nuk obligohet të rimburojë klientin për çdo humbje që rrjedh nga ndryshimi i vlerës së transaksioneve në rastet kur kundërpala qendrore e kualifikuar (ang.QCCP) dështon, anëtari i kliringut nuk duhet të përfshijë në masën e ekspozimit të treguesit të leverazhit atë çka rezulton nga tregtimi me kundërpalën qendrore të kualifikuar (ang.QCCP).
 13. Në rastet kur klienti hyn në mënyrë direkte në transaksione të derivativëve me kundërpalën qendrore dhe kur anëtari i kliringut i garanton kundërpalës qendrore për performancën e ekspozimeve tregtare derivative të klientit të tij, banka që ushtron funksionin e anëtarit të kliringut për klientin tek kundërpala qendrore duhet të llogarisë ekspozimin për treguesin e leverazhit që rezulton nga garancia si ekspozim derivativ në pajtim me kushtet e përcaktuara në paragrafët 1 deri 10 të këtij neni, ashtu sikur të ishte përfshirë në mënyrë direkte në këtë transaksion me klientin sa i përket pranimit apo provizionimit të margjinës ndryshuese në para të gatshme (ang. cash variation margin).
 14. Derivatvët kreditorë të shkruar (ang.written credit derivatives) trajtohen në mënyrë të njëjtë me instrumentet në para të gatshme (p.sh. kreditë, obligacionet) për qëllim të masës së ekspozimit.

15. Në mënyrë që të llogaritet ekspozimi kreditor ndaj entitetit referencë bazë, përveç trajtimit të lartëpërmendur ndaj rrezikut kreditor të kundërpalës për derivativët dhe kolateralin, në masën e ekspozimit duhet të përfshihet shuma nocionale efektive që referohet nga derivativi kreditor i shkruar. Shuma efektive nocionale përfitohet duke rregulluar shumën nocionale për të pasqyruar ekspozimin e vërtetë të kontratave që janë të realizuara përmes leverazhit apo të realizuara përmes strukturës së transaksionit. Shuma efektive nocionale e derivativit kreditor të shkruar (ang. *written credit derivative*) mund të zvogëlohet nga çdo ndryshim negativ në vlerën e drejtë që është përfshirë gjatë llogaritjes së Kapitalit të klasës së parë sa i përket derivativit kreditor të shkruar. Shuma e rezultuar mund të zvogëlohet edhe më tutje nga shuma efektive nocionale e derivativit kreditor të blerë që ka të njëjtin emër referues, nëse:
- 15.1. mbrojtja kreditore e blerë është në detyrimin referencë që renditet në mënyrë të njëjtë (*pari passu*) apo më poshtë se detyrimi referencë bazë (*ang. underlying reference obligation*) i derivativit kreditor të shkruar në rastet e derivativëve kreditorë me një emër të vetëm; dhe
- 15.2. maturiteti i mbetur i mbrojtjes kreditore të blerë është i njëjtë apo më i gjatë sesa maturiteti i mbetur i derivatit kreditor të shkruar.
16. Meqenëse derivativët kreditorë të shkruar janë të përfshirë në masën e ekspozimit sipas shumës efektive nocionale, dhe janë subjekt i vlerave shtesë për ekspozimet e mundshme të së ardhmes (ang. PFE), masa e ekspozimit për derivativët kreditor të shkruar mund të jetë e mbivlerësuar. Bankat në këtë rast mund të vendosin të zvogëlojnë në baza individuale vlerën shtesë (add-on amount) për ekspozimet e mundshme të së ardhmes (PFE) për derivativët kreditor të shkruar (që nuk është kompensuar sipas paragrafit 15 të këtij neni dhe shuma nocionale efektive e të cilëve është përfshirë në masën e ekspozimit) nga vlera shtesë bruto e tyre (gross add-on) në paragrafët 1-5 të këtij neni.

Neni 8

Ekspozimet e transaksioneve të financimit të letrave me vlerë

1. Transaksionet e financimit të letrave me vlerë përfshihen në masën e ekspozimit në pajtueshmëri me paragrafët 2 deri 7 të këtij neni.
2. Trajtimi i përgjithshëm i bankës që vepron si kryesuese e transaksionit është mbledhja e shumave në paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni dhe duhet të përfshihet në masën e ekspozimit të treguesit të leverazhit.
3. Asetet bruto të transaksioneve të financimit të letrave me vlerë që janë njohur për qëllime të kontabilitetit (d.m.th., rastet kur nuk pranohet netimi në kontabilitet) janë të rregulluara si në vijim:
 - 3.1. aty ku banka ka njohur letrat me vlerë si asete në bilancin e gjendjes, duke përjashtuar nga masa e ekspozimit çdo letër me vlerë të pranuar si transaksion i financimit të letrave me vlerë dhe

- 3.2. paraja e gatshme e pagueshme dhe e arkëtueshme në transaksionet e financimit të letrave me vlerë me kundërpalën e njëjtë mund të maten neto nëse janë plotësuar të gjitha kriteret e mëposhtme:
 - 3.2.1. Transaksionet kanë datë eksplicite të njëjtë të shlyerjes përfundimtare;
 - 3.2.2. E drejta për të shlyer shumën borxh ndaj kundërpalës me shumën borxh që ka kundërpala është ligjrisht e zbatueshme si në rrjedhën normale të biznesit ashtu edhe në rast të dështimit, paaftësisë paguese ose falimentimit;
 - 3.2.3. Kundërpalët synojnë të shlyejnë neto apo njëkohësisht transaksionet, apo transaksionet janë subjekt i një mekanizmi të shlyerjes që jep rezultat të njëjtë funksional sikurse shlyerja neto, domethënë, rrjedhat e parasë nga transaksionet janë ekuivalente, në të vërtetë, me një shumë të vetme neto në datën e shlyerjes. Për të arritur një ekuivalencë të tillë, të dy transaksionet duhet të shlyhen përmes sistemit të njëjtë të shlyerjes dhe marrëveshjet e shlyerjeve duhet të mbështeten nga paraja e gatshme dhe/apo angazhimet kreditore brendaditore me qëllim që të sigurohet që shlyerja e të dy transaksioneve të bëhet deri në fund të ditës së punës si dhe ndërlihdhet me rrjedhat e kolateralit nuk rezultojnë në një komplikim të shlyerjes neto të parasë së gatshme.
4. Masa e rrezikut kreditor të kundërpalës e llogaritur si ekspozim aktual pa vlerën shtesë për ekspozimet e mundshme të së ardhmes, llogaritet si në vijim:
 - 4.1. Kur një kontratë master netimi e kualifikuar është në fuqi, ekspozimi aktual (E^*) është më i madh se zero dhe gjithsej vlera e drejtë e letrave me vlerë dhe e parasë së gatshme të huazuar te kundërpala për të gjitha transaksionet e përfshira në kontratën master netimi të kualifikuar ($\sum E_i$), minus gjithsej vlera e drejtë e parasë së gatshme dhe letrave me vlerë të pranuar nga kundërpala për ato transaksione ($\sum C_i$). Kjo është e ilustruar në formulën e paraqitur në vijim: $E^* = \max \{0, [\sum E_i - \sum C_i]\}$
 - 4.2. Kur një kontratë master netimi e pakualifikuar është në fuqi, ekspozimi aktual për transaksionet me kundërpalën duhet të llogaritet në bazë të secilit transaksion në veçanti: që do të thotë se secili “transaksion i” trajtohet në bazë të një grupi të vet netimi, siç është paraqitur në formulën në vijim: $E_i^* = \max \{0, [E_i - C_i]\}$
5. Në rastet ku arrihet kontabiliteti i shitjes për një transaksion të financimit të letrave me vlerë sipas kornizës operative kontabël të bankës, banka duhet të kthejë të gjitha regjistrimet kontabël që lidhen me shitjet, dhe pastaj të llogarisë ekspozimin e saj sikurse transaksioni i financimit të letrave me vlerë të ishte trajtuar si transaksion financues sipas kornizës operative kontabël (d.m.th., banka duhet të përfshijë shumën e vlerave në nënparagrafët a) dhe b) të paragrafit 8 të nenit 7 të kësaj rregullore për një transaksion të tillë të financimit të letrave me vlerë për qëllim të përcaktimit të masës së ekspozimit).
6. Kur banka vepron si agent në transaksionet e financimit të letrave me vlerë ofron dëmshpërblim apo garanci ndaj një klienti apo kundërpale për çdo diferencë në mes të vlerës së letrës me vlerë apo parasë së gatshme që klienti ka huazuar dhe vlerës së kolateralit që

huamarrësi ka siguruar, atëherë bankës i kërkohet të llogarisë masën e ekspozimit vetëm sipas paragrafit 4 të këtij neni.

7. Kur banka vepron si agjent në transaksionet e financimit të letrave me vlerë dhe ofron dëmshpërblim apo garanci ndaj një klienti apo kundërpale do të konsiderohet e pranueshme për trajtim (të veçantë) sipas përcaktimeve të paragrafit 6 të këtij neni vetëm nëse ekspozimi i bankës ndaj transaksionit është limituar deri në diferencën e garantuar në mes të vlerës së letrës me vlerë apo parasë së gatshme që klienti i saj ka huazuar dhe vlerës së kolateralit që huamarrësi ka siguruar. Në situatat kur banka është ekonomikisht e ekspozuar më tepër (d.m.th., përtej garancisë për diferencë) ndaj letrës me vlerë bazë apo parasë së gatshme në transaksion, në masën e ekspozimit duhet të përfshihet një shumë e ekspozimit e barabartë me shumën e plotë të letrës me vlerë apo parasë së gatshme.

Neni 9

Zërat jashtëbilancor

1. Zërat jashtëbilancor të definuar në Aneksin 1 të Rregullores për Adekuatshmerine e Kapitalit të Bankave duhet të përfshihen në masën e ekspozimit për treguesin e leverazhit.
2. Zërat jashtëbilancor përfshijnë zotimet (duke përfshirë angazhimet e likuiditetit) pavarësisht nëse janë apo jo të anulueshme pa kushte, zëvendësit direkt kreditor, pranimet, letrat kreditore “*standby*” dhe letrat tregtare kreditore.
3. Zërat jashtëbilancor duhet të konvertohen sipas qasjes së standardizuar në ekuivalent të ekspozimeve kreditore duke përdorur faktorët konvertues.
4. Për qëllim të përcaktimit të shumës së ekspozimit të zërave jashtëbilancor për llogaritjen e treguesit të leverazhit, faktorët konvertues të përcaktuar në Aneksin 1 të Rregullores për Adekuatshmerine e Kapitalit të Bankave, duhet të aplikohen në shumën nominale.
5. Për qëllim të llogaritjes së treguesit të leverazhit, çdo zotim që është i anulueshëm pa kushte në çdo kohë nga banka pa njoftim paraprak, apo në mënyrë efektive siguron anulimin automatik për shkak të përkeqësimit të aftësisë pagueuse të huamarrësit, do të trajtohet me faktor konvertues prej 10% .

Neni 10

Publikimi i treguesit të leverazhit

Bankat duhet të publikojnë treguesin e leverazhit në bazë të konsoliduar në të njëjtën kohë kur i publikojnë edhe pasqyrat financiare të tyre.

Neni 11

Raportimi në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës

Bankat duhet të dorëzojnë në BQK, format e raportimit të përcaktuara nga BQK, sipas instruksioneve përkatëse, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas përfundimit të çdo tremujori, së bashku me raportet e rregullta tremujore.

Neni 12

Zbatimi, masat përmirësuese dhe dënimet civile

Çdo shkelje e dispozitave të kësaj rregulloreje do të jetë subjekt i masave përmirësuese dhe ndëshkuese, siç përcaktohet në Ligjin për Bankën Qendrore dhe Ligjin për bankat.

Neni 13

Anekset

Pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje është Aneksi 1.

Neni 14

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi më datën 01.01.2020.

Flamur Mrasori

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Aneksi I

1. Ky aneks përmban kërkesa shtesë për qëllim të llogaritjes së treguesit të leverazhit.
2. Faktorët e vlerës shtesë në vijim aplikohen në derivativët financiarë bazuar në maturitetin e mbetur:

Tabela 1.

Periudha	Normat e interesit	Këmbimet valutore dhe ari	Instrumentet e kapitalit	Metalet e çmuara përveç arit	Mallrat tjera
Një vit ose më pak	0.0%	1.0%	6.0%	7.0%	10.0%
Mbi një vit deri në pesë vite	0.5%	5.0%	8.0%	7.0%	12.0%
Mbi pesë vite	1.5%	7.5%	10.0%	8.0%	15.0%

- 2.1. Për kontratat që përfshijnë shkëmbime të shumëfishta të principalit, faktorët duhet të shumëzohen me numrin e pagesave të mbetura sipas kontratës.
 - 2.2. Për kontratat që janë të strukturuar për të shlyer ekspozimet e mbetura pas datave të specifikuar të pagesave dhe ku afatet rivendosen në mënyrë të tillë që vlera e tregut të kontratës të jetë zero në këto data të caktuara, maturiteti i mbetur do të caktohet në të njëjtën kohë deri në datën e ardhshme të rivendosjes. Në rastet e kontratave të normave të interesit me maturitetet të mbetur prej më shumë se 1 vit dhe që plotësojnë kriteret e mësipërme, vlera shtesë është subjekt i limitit minimal prej 0.5%.
 - 2.3. Kontratat me pajtim paraprak, kontratat e kundërkëmbimit, opsionet e blera dhe kontratat e ngjashme derivative që nuk janë të përfshira në asnjë kolonë të kësaj matrice duhet të trajtohen si “mallrat tjera”.
 - 2.4. Asnjë ekspozim kreditor i mundshëm i së ardhmes nuk do të llogaritet për valutat e vetme me normë variable / kontratat e kundërkëmbimit me normë interesi variable; ekspozimi kreditor për këto kontrata duhet të vlerësohet vetëm në bazë të vlerës së tyre të tregut. (ang. mark-to-market value).
3. Në rast se shuma nocionale e dhënë është huazuar apo është rritur përmes strukturës së transaksionit, bankat duhet të përdorin shumën nocionale efektive kur përcaktojnë ekspozimin e mundshëm të së ardhmes.
 4. Faktorët shtesë në vijim aplikohen për derivativët kreditorë me një emër:

Tabela 2.

	Blerësi i mbrojtjes	Shitësi i mbrojtjes
Kontratë kundërkëmbimi për shlyerje gjithsej		
Detyrimi referencë “i kualifikuar”	5%	5%
Detyrimi referencë “jo-i kualifikuar”	10%	10%
Kontratë kreditore kundërkëmbimi e dështuar/pashlyer		
Detyrimi referencë “i kualifikuar”	5%	5% **
Detyrimi referencë “jo-i kualifikuar”	10%	10% **
Nuk do të ketë diferencime bazuar në maturitetin e mbetur.		
** Shitësi i mbrojtjes së kontratës kreditore kundërkëmbimi të dështuar/pashlyer do të jetë subjekt i faktorit shtesë vetëm atëherë kur është subjekt i mbylljes si pasojë e paaftësisë paguese të blerësit të mbrojtjes përderisa instrumenti bazë prej nga rrjedh kjo kontratë është ende solvent. Vlera shtesë në këtë rast duhet të kufizohet deri në vlerën e primeve të papaguara.		

5. Në rastet kur derivativi kreditor është një transaksion së pari - për të dështuar (ang. first-to-default), vlera shtesë do të përcaktohet nga kualiteti kreditor më i ulët që gjendet në shportë, d.m.th., nëse ekziston ndonjë pozicion i pakualifikuar në shportë, atëherë duhet të përdoret detyrimi referencë i pakualifikuar. Për transaksionin e dytë dhe n-th për të dështuar (ang. nth-to-default), asetet bazë duhet të shpërndahen sipas kualitetit kreditor, d.m.th., kualiteti kreditor i dytë apo kualiteti kreditor nth më i ulët do të përcaktojë shtesën për transaksionin së dyti- për të dështuar, respektivisht nth-për të dështuar.
6. Kategoria “i kualifikuar” përfshin letrat me vlerë të emetuara nga entitetet e sektorit publik dhe bankave shumëpalëshe të zhvillimit, si dhe letrat tjera me vlerë që janë:
 - 6.1. vlerësuar si klasë investuese nga së paku dy institucione për vlerësime të jashtme kreditore të pranuar nga BQK-ja; apo
 - 6.2. vlerësuar si klasë investuese nga një institucion për vlerëzimin e jashtëm kreditor dhe vlerësuar jo më pak se klasa investuese nga ndonjë institucion tjetër për vlerësime kreditore të pranuar nga BQK-ja. (subjekt i mbikëqyrjes/vlerësimit nga BQK); apo
 - 6.3. subjekt i aprovimit nga BQK, që nuk kanë vlerësim, por që konsiderohen të jenë si apo të krahasohen me kualitet kreditor të klasës investuese nga banka raportuese, dhe kur *emetuesi* ka letra me vlerë të listuara në bursë të njohur.
7. Për më tepër, kategoria "i kualifikuar" përfshin letrat me vlerë të emetuara nga institucionet që konsiderohen të jenë ekuivalente me cilësinë e klasës investuese dhe subjekt i mbikëqyrjes dhe rregullimeve rregullative.

8. Në rastet e netimit bilateral, për qëllim të treguesit të leverazhit, do të zbatohen si më poshtë:
 - 8.1. Bankat mund të netojnë transaksionet që janë subjekt i zëvendësimit të kontratës së vjetër me një kontratë të re sipas së cilës çdo detyrim në mes të bankës dhe kundërpalës së saj për të dorëzuar një valutë të dhënë në një datë të kryerjes së pagesës që në mënyrë automatike të bashkohet me të gjitha detyrimet tjera për të njëjtën valutë dhe datë të kryerjes së pagesës, duke zëvendësuar ligjërisht një shumë të vetme për detyrimet e mëparshme bruto.
 - 8.2. Bankat gjithashtu mund të netojnë transaksionet që janë subjekt i ndonjë forme ligjërisht të vlefshme të netimit bilateral që nuk është përfshirë në pikën a), që përfshinë forma tjera të zëvendësimit të kontratës së vjetër me një kontratë të re.
9. Në të dyja rastet sipas nën paragrafëve 8.1. dhe 8.2. të paragrafit 8 të këtij neni, banka duhet të dëshmojë në BQK që posedon:
 - 9.1. një kontratë apo marrëveshje netimi me kundërpalën që krijon një obligim ligjor të vetëm, që mbulon të gjitha transaksionet e përfshira, ashtu që banka të ketë një kërkesë për të pranuar apo detyrim për të paguar vetëm shumën neto të vlerave pozitive dhe negative sipas vlerës së tregut të transaksioneve individuale të përfshira në rastet kur kundërpala dështon për shkak të: dështimit, falimentimit, likuidimit apo rrethanave të ngjashme;
 - 9.2. opinion ligjor të shkruar dhe të arsyetuar që në rast të kontestit ligjor, gjykatat relevante dhe autoritetet administrative do të gjenin shumën neto të ekspozimit të bankës sipas:
 - 9.2.1. ligjit të jurisdiksionit në të cilin është e themeluar kundërpala dhe nëse filiala e huaj e kundërpalës është e përfshirë, atëherë sipas ligjit të jurisdiksionit në të cilin kjo filialë ndodhet;
 - 9.2.2. ligjit që rregullon transaksionet individuale; dhe
 - 9.2.3. ligjit që rregullon kontratat apo marrëveshjet e nevojshme që kanë ndikim gjatë netimit.
 - 9.3. procedurat për të siguruar që karakteristikat ligjore të marrëveshjeve të netimit rishikohen vazhdimisht në rastet e mundshme të ndryshimit në ligjet përkatëse.
10. Kontratat që përmbajnë klauzolat e pagesës së largimit nuk do të jenë të pranueshme për qëllime të netimit gjatë llogaritjes së kërkesës për treguesin e leverazhit në pajtueshmëri me këtë rregullore. Klauzola e pagesës së largimit është një dispozitë që lejon kundërpalën e cila nuk ka dështuar të kryej vetëm pagesa të limituara, apo të mos paguaj fare, kundrejt një dështuesi edhe nëse dështuesi është kreditor neto.
11. Ekspozimi kreditor në transaksionet me pajtim paraprak që netohen në mënyrë bilaterale llogaritet duke mbledhur shumën e neto kostos zëvendësuese sipas vlerës së tregut, nëse është pozitive, dhe vlerës shtesë (ang. add-on) të bazuar në principalin bazë nocional. Vlëra shtesë për transaksionet e netuara (ang. ANet) do të jetë e barabartë me mesataren e peshuar të bruto

vlerës shtesë (ang. *AGross*) dhe bruto vlera shtesë e rregulluar me raportin në mes të neto kostos zëvendësuese aktuale ndaj bruto kostos zëvendësuese aktuale (*NGR*). Kjo është shprehur me formulën në vijim:

11.1. $ANet = 0.4 \cdot AGross + 0.6 \cdot NGR \cdot AGross$, ku *NGR* – nënkupton niveli i neto kostos zëvendësuese / niveli i bruto kostos zëvendësuese për transaksionet që janë subjekt i marrëveshjeve të netimit që janë ligjërisht të zbatueshme, ndërsa *AGross* – nënkupton shuma e *vlerave shtesë* individuale (të llogaritura duke shumëzuar shumën nocionale të principalit me faktorët shtesë të përshtatshëm të përcaktuar në paragrafët 1 deri 7 të këtij Aneksi) të të gjitha transaksioneve që janë subjekt i marrëveshjeve netimi që janë ligjërisht të zbatueshme me një kundërpalë.

12. Për qëllim të llogaritjes së ekspozimit kreditor të mundshëm të së ardhmes të kundërpalës netuese për kontratat me pajtim paraprak të këmbimit valutor dhe kontratat tjera të ngjashme në të cilat shuma nocionale e principalit është e barabartë me rrjedhat e parasë, principalin nocional definohet si neto pranime që skadojnë në secilën datë pagese në çdo valutë. Arsyeja për këtë është që kontratat kompensuese në valutë të njëjtë që maturojnë në datë të njëjtë kanë ekspozim potencial të së ardhmes më të ulët si dhe ekspozim aktual më të ulët.

13. Kur bankat ekspozohen ndaj transaksioneve të financimit të letrave me vlerë, marrëveshjet e netimit duhet të:

13.1. sigurojnë palën që nuk ka dështuar me të drejtën e përfundimit dhe mbylljes në kohë të përshtatshme të të gjitha transaksioneve sipas marrëveshjes në rastet e dështimit, duke përfshirë rastet e paaftësisë paguese apo falimentimit të kundërpalës;

13.2. të sigurojë për netimin e fitimeve dhe humbjeve në transaksione (duke përfshirë vlerën e çdo kolaterali) të ndërprera dhe të mbyllura në mënyrë që një shumë neto e vetme është detyrim i një pale ndaj tjetrës;

13.3. lejojnë likuidim të shpejtë apo shlyerje të kolateralit në rast të dështimit; dhe

13.4. jenë së bashku me të drejtat që vijnë nga dispozitat e kërkuara në 13.1 dhe 13.3 më lartë , ligjërisht të zbatueshme në çdo juridiksion përkatës në rast të ndodhjes së një ngjarje dështimi pavarësisht paaftësisë paguese të kundërpalës apo falimentimit.

14. Netimi në mes të pozicioneve të mbajtura në librin e bankës dhe librin tregtar do të njihet vetëm kur transaksionet e netuara të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

14.1. të gjitha transaksionet janë vlerësuar me vlerë të tregut në baza ditore; dhe

14.2. instrumentet e kolateralit të përdorura në transaksione janë të njohura si kolateral financiar i pranueshëm në librin e bankës.